

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 326, Datë 15.12.2025

MBI

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 216, DATË 18.09.2025 “MBI DHËNIEN E  
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON  
INTERESAT E SHOQËRISË “D I E Z E L A” SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2358/8 prot., datë 13.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 216, datë 18.09.2025 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “D I E Z E L A” sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “D I E Z E L A” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.01.2020, i ndryshuar, nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1.98 MW, me vendndodhje Përroi i Zallit të Madh, degë e përroit të Ljusës, Bashkia Mat, Qarku Dibër.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 216, datë 18.09.2025, ka miratuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e të licencuarit.
- Me shkresën nr. 2358/4 prot., datë 22.09.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me vendimin e sipërcituar të bordit të ERE.
- Në përgjigje, MIE i është drejtuar ERE-s me shkresën protokolluar në ERE me nr. 2358/5 prot., datë 05.11.2025 dhe i ka bërë me dije se ka pasur komunikim shkresor me shoqërinë, ku i ka sjell në vëmendje se ka konstatuar ndryshim të strukturës së ortakërisë së saj, pa pëlqimin paraprak të MIE-s, pra në kundërshtim me parashikimet e nenit 15 “Kufizime”, të kontratës të datë 10.01.2015 për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC “Ljusa”.
- Ndaj ERE me shkresën nr. 2358/6 prot., datë 13.11.2025, i është drejtuar shoqërisë dhe i ka kërkuar informacion/dokumentacion në lidhje me sa më sipër referuar nga MIE.
- Shoqëria me shkresën nr. 2358/7 prot., datë 27.11.2025, ka sqaruar se ka vendosur të kthejë kuotat në gjendjen e mëparshme, d.m.th. të transferojnë pronësinë mbi kuotat e saj sërish të Z. K M (që përfaqëson 100% të kapitalit).
- Në vijim, shoqëria ka përcjellë shkresën ku i është drejtuar MIE-s, datë 29.10.2025, protokolluar në MIE me nr. 29/10, datë 29.10.2025, më anë të të cilës kërkon miratimin e MIE-s në lidhje me ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, *specifikisht nga Z.*

*K M (me 100% të kapitalit) tek Z. L M (55% të kapitalit) dhe Z. C Q (45% të kapitalit).*

- Për gjithë sa më sipër, në përputhje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton, ndër të tjera se, një akt administrativ mund të anulohet ose shfuqizohet nga organi publik që e ka nxjerrë, nga organi epror i tij, ose nga një organ tjetër kompetent, sipas ligjit, vlerësohet të shfuqizohet vendimi nr. 216, datë 18.09.2025 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “D I E Z E L A” sh.p.k.”. Si e tillë, kuotat e shoqërisë do të vijojnë të mbahen nga ortaku i shoqërisë Z. K M, sikurse rezultonin para vendimit të bordit të ERE nr. 216, datë 18.09.2025, deri në momentin kur shoqëria të marrë miratimin e MIE-s në lidhje me transferimin e kërkuar dhe të depozitojë në ERE sa kërkuar në nenit 7 të rregullores nr. 235/2021, përfshirë kontratën e nënshkruar midis palëve, në mënyrë që të marrë autorizimin përkatës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 216, datë 18.09.2025 mbi kërkesën e shoqërisë “D I E Z E L A” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
2. Drejtoria e Licencimeve dhe Autorizimeve të lajmërojë shoqërinë “D I E Z E L A” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**